

**KOMISIONI EVROPIAN  
KUNDËR RACIZMIT DHE INTOLERANCËS**

**REKOMANDIM N° 7  
PËR POLITIKËN E PËRGJITHSHME I ECRI-T**

**MBI LEGJISLACIONIN KOMBËTAR  
PER LUFTEN KUNDER RACIZMIT  
DHE DISKRIMINIMIT RACIAL**

**MIRATUAR MË 13 DHJETOR 2002  
DHE AMENDUAR MË 7 DHJETOR 2017**

Council of Europe  
F - 67075 STRASBOURG Cedex  
Tel.: +33 (0) 3 90 21 46 62  
E-mail: [ecri@coe.int](mailto:ecri@coe.int)

Vizitoni ueb-saitin tonë: [www.coe.int/ecri](http://www.coe.int/ecri)

## **Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)**

Duke patur parasysh Deklaratën e kryetarëve të shteteve dhe të qeverive të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, miratuar në Samitin e parë të mbajtur në Vienë më 8-9 tetor 1993;

Duke patur parasysh që Plani i Veprimit për të luftuar Racizmin, Ksenofobinë, Antisemitizmin dhe Intolerancën, pati si qëllim, si pjesë e kësaj Deklarate, të ftonte Komitetin e Ministrave të themelonte Komisionin Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës me mandat inter alia, për të formuluar Politikën e Përgjithshme Rekomanduese për Shtetet anëtare;

Duke kujtuar gjithashtu Deklaratën Përfundimtare dhe Planin e Veprimit të miratuar nga kryetarët e shteteve dhe qeveritë e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës të mbajtur në samitin e dytë në Strasburg në 10-11 Tetor 1997;

Duke kujtuar Nenin 1 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, e cila deklaron se të gjithë qëniet njerëzore lindin të lira dhe të barabarta në dinjitet dhe në të drejta;

Duke patur në vëmendje Konventën Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit;

Duke patur në vëmendje Konventën Nr.111 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës për Diskriminimin (Punësim dhe Profesione);

Duke patur në vëmendje Artikullin 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

Duke pasur në vëmendje Protokollin Nr 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila përmban një nen të përgjithshëm që ndalon diskriminimin;

Duke patur në vëmendje jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;

Duke patur parasysh Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian;

Duke pasur parasysh Direktivën 2000/43/EC të Këshillit të Bashkimit Evropian që ka plotësuar parimet e trajtimit të barabartë midis personave, pavarësisht racës apo origjinës etnike dhe Direktivën 2000/78/EC të Këshillit të Bashkimit Evropian e cila ka vendosur një kuadër të përgjithshme për trajtim të barabartë në punë dhe në profesione;

Duke pasur në vëmendje Konventën për Parandalimin e Torturës dhe Krimin të Genocidit;

Duke kujtuar Rekomandimin Nr1 të ECRI-t kundër racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës dhe Rekomandimin Nr 2 të ECRI-t mbi organet e specializuara kundër racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës në nivel kombëtar;

Duke theksuar se në raportet për shtetet ECRI u rekomandon në mënyrë të vazhdueshme anëtarëve të Shteteve të miratojnë masa ligjore efektive me qëllim për të luftuar racizmin dhe diskriminimin racial;

Duke kujtuar që në Deklaratën Politike të miratuar në 13 Tetor 2000 në Konferencën Evropiane kundër racizmit, qeveritë e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës u angazhuan për të miratuar dhe plotësuar, sa herë që të jetë e nevojshme, legjislativën kombëtar dhe masat administrative që shprehimisht dhe specifikisht janë kundër racizmit dhe parandalojnë diskriminimin racial në të gjitha sferat e jetës shoqërore;

Duke kujtuar gjithashtu Deklaratën dhe Programin e Veprimit të miratuar në Konferencën Botërore kundër Racizmit, Diskriminimit Racial, Ksenofobisë dhe Intolerancës së Shprehur, të mbajtur në Durban, Afrikë e Jugut nga 31 Gushti deri më 8 Shtator 2001;

Të vetëdijshëm që vetëm ligjet nuk janë të mjaftueshme për të çrrënjësuar racizmin dhe diskriminimin racial, por të bindur që ligjet janë thelbësore në luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racial;

Duke theksuar rëndësinë jetike të masave ligjore të përshtatshme në luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racial, në mënyrë efektive dhe në një mënyrë në të cilën aktet bashkë si garantues dhe për sa më gjatë të jetë e mundur, të perceptohen si të pranueshme nga viktimat;

Të bindur që veprimtaria legjislative e Shteteve kundër racizmit dhe diskriminimit racial do të luajë gjithashtu një funksion edukativ brenda shoqërisë, duke trasmetuar mesazhin e fuqishëm që asnjë përpjekje që legjitimon racizmin dhe diskriminimin racial nuk do të tolerohet në një shoqëri ku mbizotëron ligji;

Duke dashur, pranë përpjekjeve të tjera në nivel Evropian dhe ndërkombëtar, të mbështesim Shtetet anëtare në luftën e tyre kundër racizmit dhe diskriminimit racial, të përcaktohen në mënyrë të saktë dhe të përmbledhur elementët kryesorë për t'u përfshirë në legjislacionin e përshtatshëm kombëtar;

ECRI rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare:

- a) Të miratojnë legjislacionin kundër racizmit dhe diskriminimit racial, nëse një legjislacion i tillë ende nuk ekziston ose është i paplotë;
- b) Të sigurojnë që legjislacioni kundër racizmit dhe diskriminimit racial të jetë i pajisur me komponentët kryesorë të dhënë më poshtë.

# Elementët kryesorë të legjislacionit kundër racizmit dhe diskriminimit racial

## I. Përkufizime

1. Për qëllimet e këtij rekomandimi, do të përdoren përkufizimet në vazhdim:
  - a) "racizëm" do të thotë besimi se shkaqe si raca<sup>1</sup>, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia, ose origjina etnike ose kombëtare, justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash.
  - b) "diskriminimi racial i drejtëpërdrejtë", do të thotë çdo trajtim i ndryshëm i bazuar në shkaqe si : raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia, ose origjina etnike ose kombëtare, të cilat nuk kanë një përligjje të arsyeshme dhe objektive. Trajtimi i ndryshëm nuk ka përligjje të arsyeshme dhe objektive nëse nuk ndjek një qëllim të ligjshëm ose nëse nuk ka një marrëdhënie proporcionale të arsyeshme midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të njohur për t'u realizuar.
  - c) "diskriminim racial tërthortë", janë rastet kur një rrethanë neutrale në dukje si një kusht, kriter ose praktikë nuk mund të përmbushet lehtësisht, ose disavantazhet për personat të cilët i përkasin një grupi të caktuar nga shkaqe të tilla si : raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, përveç rasteve kur këto rrethana kanë një përligjje të arsyeshme dhe objektive. Ky do të ishte rasti kur ndiqet një qëllim i ligjshëm dhe nëse do të kishte një marrëdhënie proporcionale të arsyeshme midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të njohur për t'u arritur.

## II. Ligji kushtetues

2. Kushtetuta duhet të parashikojë parimet e një trajtimi të barabartë, angazhimin e Shtetit për të përkrahur barazinë aq sa edhe të drejtën e individit për të qenë i lirë nga diskriminimi për shkaqe të tilla si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare. Kushtetuta mund të parashikojë se përjashtime nga parimet e trajtimit të barabartë mund të vendosen me ligj, duke parashikuar se ligji nuk përbën diskriminim.
3. Kushtetuta duhet të parashikojë se ushtrimi i lirisë së fjalës, së drejtës së tubimit dhe të krijimit të shoqatave mund të kufizohen në kuadër të luftës kundër racizmit. Cilido nga këto kufizime duhet të jetë në përputhje me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

---

<sup>1</sup> Derisa të gjitha qëniet njerëzore i përkasin species së njëjtë, ECRI përjashton teoritë e bazuara në racat e ndryshme. Megjithatë, në këtë rekomandim ECRI e përdor këtë term për të siguruar ata persona të cilët përgjithësisht dhe gabimisht perceptojnë se i përkasin një race tjetër, që nuk janë të përjashtuar nga mbrojtja e parashikuar nga legjislacioni.

### III. Ligji civil dhe administrativ

4. Ligji duhet të përcaktojë qartë dhe të ndalojë diskriminimin racial direkt dhe atë të tërthortë.
5. Ligji duhet të parashikojë se ndalimi i diskriminimit nuk pengon shërbimet ose miratimet e përkohshme të masave të veçanta gjithashtu të përcaktuara për të ndaluar ose kompensuar disavantazhet e pësuar nga personat e përcaktuar për një nga shkaqet e renditura në paragrafin 1/ b, (tani e tutje referuar: shkaqet e renditura), ose për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë në të gjitha fushat e jetës. Këto masa nuk duhet të vazhdojnë kur objektivi i menduar të jetë arritur.
6. Ligji duhet të parashikojë që aktet në vazhdim, *inter alia*, konsiderohen si forma diskriminimi: izolimi, diskriminim nga përkatësia shoqërore, qëllim i shpallur diskriminimi, udhëzimi i të tjerëve për të diskriminuar; nxitja e personave të tjerë për të diskriminuar, ndihmesa dhënë një personi tjetër për të diskriminuar.
7. Ligji duhet të parashikojë se ndalimi i diskriminimit u adresohet të gjitha autoriteteve publike aq sa edhe të gjithë personave fizikë dhe personave juridikë, si në jetën publike ashtu edhe në sektorin privat, në të gjitha fushat, sidomos në: punësim, anëtarësim në sindikata, edukim, trainim, strehim, shëndetësi, mbrojtje sociale, të mirat dhe shërbimet e menduara për shoqërinë dhe për vendet publike, ushtrimi i veprimtarisë ekonomike, shërbimet publike.
8. Ligji duhet të vendosë autoritetet publike nën detyrimin për të përkrahur barazinë dhe për të ndaluar diskriminimin gjatë kryerjes së funksioneve të tyre.
9. Ligji duhet t'i vendosë autoritetet publike nën detyrimin për të siguruar që ato palë të cilave u japin kontrata, huadhënie, grante ose përfitime të tjera, të respektojnë dhe të përkrahin praktikën jo-diskriminuese. Veçanërisht, ligji duhet të parashikojë që autoritetet publike në dhënien e kontratave, huadhënieve, granteve dhe përfitimeve të tjera, do t'i nënshtrohen kushtit që politika e mosdiskriminimit do të respektohet dhe miratohet edhe nga palët e tjera. Ligji duhet të parashikojë se shkelja e këtij kushti mund të çojë në prishjen e kontratës, mosdhënies së grantit ose benefiteve të tjera.
10. Ligji duhet të sigurojë që aksesin e lirë në procedurat gjyqësore dhe/ose administrative, përfshirë procedurat e pajtimit, janë të disponueshme për të gjitha viktimat e diskriminimit. Në raste emergjente, procedurat e përshpejtuara, lidhur me vendimet e përkohshme, duhet të jenë të disponueshme për viktimat e diskriminimit.
11. Ligji duhet të parashikojë se, në qoftë se persona, të cilët pretendojnë se u është bërë një padrejtësi për shkak të një akti diskriminues të krijuar nga një gjykatë ose nga çdo autoritet kompetent, fakte të cilat mund të prezumohen se kanë qënë drejtëpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë diskriminues duhet të provohen nga i padituri për të kundërtën.
12. Ligji duhet të parashikojë sanksione efektive, proporcionale dhe bindëse për rastet e diskriminimit. Këto sanksione duhet të përfshijnë pagesën e zhdëmtimit si për dëmin material ashtu edhe për atë moral të viktimave.

13. Ligji duhet të parashikojë mjetet e nevojshme ligjore për të kontrolluar, mbi veprime bazë, përshtatjen me ndalimet e diskriminimit për të gjitha ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative në nivel vendor dhe kombëtar. Ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të gjetura jo në përputhje me ndalimet e diskriminimit duhet të ndryshohen ose shfuqizohen.
14. Ligji duhet të parashikojë se dispozitat diskriminuese të cilat janë të përfshira në kontrata ose marrëveshje individuale ose kolektive, rregullore të brendshme të ndërmarrjeve, rregulla që udhëheqin shoqatat fitimprurëse ose jo fitimprurëse, dhe rregulla që udhëheqin profesionet e pavarura dhe organizatat e punëdhënësve ose punëmarrësve, duhet të ndryshohen ose të deklarohen nul dhe të pavlefshëm.
15. Ligji duhet të parashikojë se ngacmimi i lidhur me një nga shkaqet e renditura është i ndaluar.
16. Ligji duhet të parashikojë në mënyrë të detyruar për t'i dhënë fund financimit publik për organizatat të cilat përkrahin racizmin.
17. Ligji duhet të parashikojë mundësinë e shpërbërjes së organizatave të cilat përkrahin racizmin.

#### **IV. Ligji penal**

18. Ligji duhet të penalizojë aktet në vazhdim kur bëhen me qëllim:
  - a) nxitjen publike të dhunës, urrejtjes ose diskriminimit,
  - b) fyerjen publike dhe shpifjen ose kërcëniminkundër një personi ose një grupi personash për shkak të racës, ngjyrës, gjuhës, besimit fetar, shtetësisë ose origjinës kombëtare ose etnike;
  - d) deklaratat publike me qëllim racist, të një ideologjie e cila deklaron superioritetin e saj ose që përçmon ose degradon një grup personash mbi bazë të racës së tyre, ngjyrës, gjuhës, besimit fetar, shtetësisë ose origjinës kombëtare ose etnike;
  - e) refuzimin publik, degradimin, justifikimin ose faljen, me qëllim racist, të krimeve të genocidit, krimeve kundër njerëzimit ose krimeve të luftës;
  - f) propagandën publike ose përhapjen publike, ose prodhimin apo ruajtjen, me synimin e propagandës apo përhapjes publike me qëllim racist të shkrimeve, pikturave ose materialeve të tjera që përmbajnë shprehje që përfshihen në paragrafin 18 pikat a,b,c, d,dhe e;
  - g) krijimin ose drejtimin e një grupi që përkrah racizmin; mbështetjen e një grupi të tillë; pjesëmarrjen në aktivitetet e tij me synimin për të kontribuar në shkeljet e parashikuara në paragrafin 18 pikat a, b, c, d, e dhe f;
  - h) diskriminimin racial në ushtrimin e një detyre ose profesioni publik.

19. Ligji duhet të penalizojë genocidin.
20. Ligji duhet të parashikojë se nxitja e qëllimshme, ndihmesa, mbështetja ose tentativa për të kryer një nga shkeljet e parashikuara në paragrafët 18 dhe 19, është e ndëshkueshme.
21. Ligji duhet të parashikojë që për të gjitha veprat penale që nuk janë parashikuar në paragrafët 18 dhe 19, motivi racist do të përbëjë rrethanë rënduese.
22. Ligji duhet të parashikojë se personat juridikë janë përgjegjës sipas Kodit Penal për krimet e përcaktuar në paragrafët 18,19,20 dhe 21.
23. Ligji duhet të parashikojë në mënyrë efektive, proporcionale dhe bindëse sanksione për shkeljet e përcaktuara në paragrafët 18,19,20 dhe 21. Ligji duhet të parashikojë gjithashtu sanksione alternative ose ndihmëse.

## **V. Masa të përgjithshme**

24. Ligji duhet të parashikojë krijimin e një ose më shumë organesh të barazisë për të luftuar racizmin dhe intolerancën, siç parashikohet në Rekomandimin Nr. 2 të Politikave të Përgjithshme të ECRI-it Ligji duhet të parashikojë kompetencat e këtij organi: ndihmën për viktimat, të drejtën për të hetuar, të drejtën për të filluar dhe marrë pjesë në procesin gjyqësor, monitorimin e legjisllacionit dhe këshillimin me autoritetet ekzekutive dhe legjisllative, mirëinformimin mbi ʼështjet e racizmit dhe diskriminimit racial në shoqëri dhe mbështetjen e politikave e praktikave për të siguruar një trajtim të barabartë.
25. Ligji duhet të parashikojë që organizimet si : shoqata, sindikata dhe entitetet e tjera ligjore, të cilat kanë në pajtim me kriteret e vendosura nga ligji vendas, një interes legjitim për të luftuar racizmin dhe diskriminimin racial, kanë të drejtë të nisin çështje civile, të ndërhyjnë në çështjet administrative ose të ngrenë padi penale, edhe nëse një viktimë e veçantë nuk u është drejtuar atyre.
26. Ligji duhet të garantojë ndihmë ligjore falas dhe kur është e nevojshme caktimin e një avokati kryesisht, për viktimat të cilat dëshirojnë t'i drejtohen gjykatës si kërkues ose paditës dhe që nuk kanë mjetet e nevojshme për ta bërë këtë. Nëse është e nevojshme duhet të parashikohet edhe një përkthyes falas.
27. Ligji duhet të parashikojë mbrojtje kundër çdo veprimi të marrë ndaj personave për shkak të deklaramit nga ana e tyre se janë viktima të krimeve raciale ose diskriminimit racial, për personat që raportojnë akte të tilla ose për personat që sigurojnë prova.
28. Ligji duhet të parashikojë për një ose më shumë organe të pavarura të ngarkuara me hetimin e akteve të pretenduara si diskriminuese të kryera nga politikanë, organe drejtuese zyrtare, ushtarakë dhe personeli i burgjeve.



# Memorandum shpjegues i Rekomandimit Nr.7 të ECRI-t mbi legjislacionin kombëtar kundër racizmit dhe diskriminimit racial

## Prezantimi

1. Ky Rekomandim fokusohet mbi elementët kryesorë të legjislacionit kombëtar për të luftuar racizmin dhe diskriminimin racial. Megjithëse ECRI është i vetëdijshëm se vetëm mjetet ligjore nuk janë të mjaftueshme për këtë qëllim, beson se legjislacioni kombëtar kundër racizmit dhe diskriminimit racial është i nevojshëm për të luftuar këtë fenomen në mënyrë efektive.
2. Në kuadër të përqasjes me secilin shtet, ECRI u rekomandon në mënyrë të vazhdueshme shteteve anëtare të Këshillit të Evropës adoptimin e masave ligjore efektive me qëllimin për të luftuar racizmin dhe diskriminimin racial. Rekomandimi synon të sigurojë përtej këtyre masave dhe të qartësojë e kompletojë rekomandimet e formuluar në lidhje me raportimet e ECRI-t për secilin shtet. Rekomandimi ka si qëllim gjithashtu të reflektojë parimet e përgjithshme të përfshira në instrumentat ndërkombëtarë të përmendur në Preambul.
3. ECRI beson se legjislacioni i përshtatshëm për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racial duhet të përfshijë dispozita në të gjitha degët e së drejtës, si në të drejtën kushtetuese, civile, administrative dhe penale. Vetëm nga kjo përqasje e harmonishme, shtetet anëtare do të kenë mundësinë t'i drejtojnë këto probleme në një mënyrë e cila është shtruese, efektive dhe e kënaqshme nga këndvështrimi i viktimës si e tillë. Në fushën e luftës kundër racizmit dhe diskriminimit racial, ligji civil dhe administrativ shpesh parashikojnë mjete ligjore fleksibël, gjë e cila lehtëson kërkimin nga viktimat të mekanizmave ligjore. Ligji penal ka një efekt simbolik, që ndërgjegjëson shoqërinë për rëndësinë e racizmit dhe diskriminimit racial, ka një efekt të fortë bindës, prandaj parashikimi në të është një instrument efektiv. ECRI ka marrë parasysh faktin që mundësitë e ofruara nga fusha të tjera të së drejtës janë plotësuese. Përsa i përket, veçanërisht luftës kundër diskriminimit racial, ECRI rekomandon që shtetet anëtare të Këshillit të Evropës të miratojnë dispozita ligjore kushtetuese, civile dhe administrative dhe në raste të caktuara, të miratojnë dispozita shtesë në ligjin penal.
4. Masat ligjore të nevojshme për të luftuar racizmin dhe diskriminimin racial në nivel kombëtar janë paraqitur në formën e elementëve kryesorë të cilët duhet t'i përmbajë legjislacioni i brendshëm i shteteve anëtare. ECRI thekson se masat që rekomandon përputhen me sisteme të ndryshëm ligjorë, common law, civil law apo edhe sisteme të përziera. Veç kësaj, këto elementë që ECRI i konsideron si kryesorë për një kuadër ligjor efektiv kundër racizmit dhe diskriminimit racial mund të adaptohen sipas kushteve specifike të çdo vendi. Si rrjedhim ato mund të përcaktohen në një akt të veçantë ose të shpërndarë në akte të ndryshme të legjislacionit kombëtar (ligji civil, administrativ dhe penal). Këto elementë kryesorë mund të përfshihen në legjislacionin e gjerë duke plotësuar kuadrin ligjor në luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racial. Për shembull, kur adoptojnë masa ligjore kundër diskriminimit,

shtetet anëtare mund të ndalojnë, krahas diskriminimit racial forma të tjera diskriminimi të tilla si ato të bazuara mbi gjininë, orientimin seksual, paaftësinë, politikën ose për opinione të tjera, origjinën sociale, pronën, lindjen ose për statuse të tjera. Për ta përfunduar, në disa fusha, shtetet anëtare mundet thjesht të zbatojnë rregulla të përgjithshme, për pasojë nuk është e nevojshme të referohen në këtë rekomandim. Kështu për shembull në ligjin civil, për detyrimet shumë të mëdha, për detyrimet e tjetërsuara dhe për të përcaktuar masën e dëmit të shkaktuar; në ligjin penal, për kushtet e përgjegjësisë dhe për strukturën e vendimit; dhe në çështjet procedurale, për organizimin dhe juridiksionin e gjykatave.

5. Në çdo rast, këto elementë kryesorë përfaqësojnë vetëm një standart minimal; kjo do të thotë se ato pajtohen me dispozitat ligjore që ofrojnë një nivel më të lartë mbrojtjeje, të miratuar ose për t'u miratuar nga një shtet anëtar dhe kjo në asnjë rrethanë që do të krijonte terren për të reduktuar nivelin e mbrojtjes kundër racizmit dhe diskriminimit racial, mbrojtje e dhënë tashmë nga një shtet anëtar.

## I. Përkufizime

### *Paragrafi 1 i Rekomandimit*

6. Në Rekomandim, termi "racizëm" duhet të kuptohet në një sens të gjerë, duke përfshirë dhe fenomene si ksenofobia, antisemitizmi dhe intoleranca. Përsa i përket shkaqeve të përcaktuara në përkufizimin e diskriminimit racial i drejtëpërdrejtë dhe i tërthortë (paragrafi 1 i Rekomandimit), duke iu shtuar shkaqeve përgjithësisht të mbuluara nga instrumenta të përshtatshëm ligjorë në fushën e luftës kundër racizmit dhe diskriminimit racial, të tilla si: raca, ngjyra, dhe kombësia ose origjina etnike, Rekomandimi mbulon gjuhën, besimin fetar dhe shtetësinë<sup>2</sup>. Përfshirja e këtyre shkaqeve në përkufizimin e racizmit dhe diskriminimit racial bazohet në mandatin e ECRI-t, i cili është të luftojë racizmin, antisemitizmin, ksenofobinë dhe intolerancën. ECRI gjykon se këto koncepte, të cilat ndryshojnë në kohë, ditët e sotme mbulojnë shfaqjen e personave apo grupeve të personave të vënë në shenjë për shkaqe të tilla si raca, ngjyra, gjuha, shtetësia, origjina kombëtare ose etnike. Si rezultat, shprehjet "racizëm" dhe "diskriminim racial" të përdorura në këtë Rekomandim, përshijnë të gjitha fenomenet që mbuloohen nga mandati i ECRI-t. Origjina kombëtare është interpretuar ndonjëherë sikur të përfshinte dhe konceptin e shtetësisë. Megjithatë, për të siguruar që ky koncept është në të vërtetë i mbuluar, është shprehimisht i përfshirë në listën e shkaqeve, duke iu shtuar origjinës kombëtare. Përdorimi i shprehjes "shkaqe të tilla si" në përkufizimin e diskriminimit racial direkt dhe indirekt ka për qëllim që të krijojë një listë të hapur të shkaqeve, duke lejuar evoluimin e tij me shoqërinë. Megjithatë, në ligjin penal, një listë shterruese e shkaqeve duhet të vendoset për të respektuar parimin e parashikimit të pasojës i cili udhëheq këtë degë të së drejtës.
7. Ndryshe nga përkufizimi i diskriminimit racial (paragrafi 1/b dhe c i Rekomandimit), i cili duhet të përfshihet në ligj, përkufizimi i racizmit është parashikuar për qëllimet e Rekomandimit dhe shtetet anëtare mund ose jo të vendosin për ta përkufizuar brënda ligjit. Nëse vendosin

---

<sup>2</sup> ECRI kupton me termin "shtetësi" atë që është përkufizuar në Artikullin 2 a) të Konventës Evropiane mbi Shtetësinë: "shtetësi" do të thotë lidhja e ligjshme midis një personi dhe një shteti dhe që nuk tregon origjinën etnike të personit."

për ta bërë këtë, ato mund përsa i përket ligjit penal, të adoptojnë një përkufizim më të saktë sesa ai i përcaktuar në paragrafin 1/a, duke respektuar parimet themelore të kësaj dege të së drejtës. Për të qenë në kushtet e racizmit, nuk është e nevojshme që një ose më shumë nga shkaqet e listuara të krijojnë faktorin e vetëm ose faktorin kryesor përcaktues për përbuzjen ose nocionin e superioritetit; është e mjaftueshme që këto shkaqe të jenë midis faktorëve kryesorë përbuzës ose nocionit të superioritetit.

8. Përkufizimet e diskriminimit racial të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë të përfshira në paragrafin 1/b dhe c të Rekomandimit janë bazuar në përkufizimet e përfshira në Direktivën 2000/43/CE të Këshillit të Bashkimit Evropian duke përfshirë parimin e trajtimit të barabartë midis personave pavarësisht origjinës racore ose etnike, në Direktivën 2000/78/CE të Këshillit të Bashkimit Evropian e cila ka vendosur një kuadër të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punë dhe profesion dhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në përputhje me jurisprudencën e saj, trajtimi i ndryshëm krijon diskriminim nëse nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Ky parim zbatohet për trajtimin e ndryshëm të bazuar në një nga shkaqet e renditura në përkufizimin e diskriminimit racial. Megjithatë, trajtimi i ndryshëm i bazuar mbi racën, ngjyrën dhe origjinën etnike mund të ketë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm vetëm në raste shumë të kufizuara. Për shembull, në punësim kur ngjyra përbën një kërkesë profesionale të vërtetë dhe përcaktuese për shkak të natyrës së veçantë të kryerjes së aktivitetit profesional ose për kontekstin në të cilin ata do ta kryejnë, trajtimi i ndryshëm i bazuar mbi këtë shkak mund të ketë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Përgjithësisht, kuptimi i justifikimit objektiv dhe të arsyeshëm duhet të interpretohet në mënyrë sa më të kufizuar që të jetë e mundur në respektim të trajtimit të ndryshëm të bazuar në një nga shkaqet e renditura.

## **II. Ligji kushtetues**

9. Në këtë Rekomandim, termi “kushtetutë” duhet të kuptohet në një sens të gjerë, duke përfshirë ligjet bazë dhe rregullat bazë të shkruara apo të pashkruara. Në paragrafet 2 dhe 3, Rekomandimi parashikon për parime të caktuara që duhet të përmbahen në kushtetutë; parime të tilla duhet të implementohen duke u parashikuar me ligj dhe nga dispozitat rregulluese.

### *Paragrafi 2 i Rekomandimit*

10. Në paragrafin 2, Rekomandimi lejon mundësinë e parashikimit në ligj të përjashtimeve nga parimi i trajtimit të barabartë, me kusht që ato të mos krijojnë diskriminim. Që këto kushte të plotësohen në përputhje me përkufizimet e diskriminimit të propozuar në paragrafin 1/b dhe c të Rekomandimit, përjashtimet duhet të kenë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Ky parim aplikohet për të gjitha përjashtimet, përfshirë dhe ato të vendosura për trajtimin e ndryshëm mbi bazën e shtetësisë.

### *Paragrafi 3 i Rekomandimit*

11. Sipas paragrafit 3 të Rekomandimit, kushtetuta duhet të parashikojë se ushtrimi i lirisë së fjalës, së drejtës së tubimit dhe të krijimit të shoqatave mund të kufizohen në kuadër të luftës kundër racizmit. Në artikullin 10(2) dhe 11(2), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut rendit qëllimet të

cilat mund të justifikojnë kufizimet që i bëhen këtyre lirive. Ndonëse lufta kundër racizmit nuk është përmendur në një nga këto qëllime, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e konsideron të përfshirë në jurisprudencën e saj. Në përputhje me artikujt e Konventës të përmendura më sipër, këto kufizime duhet të parashikohen me ligj dhe domosdoshmërisht në një shoqëri demokratike.

### III. Ligji civil dhe administrativ

#### *Paragrafi 4 i Rekomandimit*

12. Rekomandimi parashikon në paragrafin 4 se ligji duhet të përcaktojë qartësisht dhe të ndalojë diskriminimin racial të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë. Ai ofron një përkufizim të diskriminimit racial direkt dhe indirekt në paragrafët 1/b dhe c. Kuptimi i shprehjes “trajtim i ndryshëm” është i gjerë dhe përfshin çdo dallim, përjashtim, kufizim, preferencë ose heqje, në të kaluarën, të tashmen ose potencialisht të mundshme. Termi “shkaqe” duhet të përfshijë shkaqe të cilat janë aktualisht, ose të prezumuara. Për shembull, nëse eksperiencia e një personi trajtohet në mënyrë të pafavorshme për shkak të prezumimit se ai ose ajo është Myslimane, kur realisht nuk është rasti, ky trajtim do të krijojë diskriminim mbi bazën e besimit fetar.
13. Aktet diskriminuese, rrallëherë janë të bazuara vetëm në një ose më shumë për shkaqet e renditura. Ato janë më tepër të bazuara në kombinimin e këtyre shkaqeve me faktorë të tjerë. Që të kemi diskriminim, është e mjaftueshme që një nga shkaqet e renditura të krijojë një nga faktorët që të çojnë në trajtim të ndryshëm. Përdorimi i shprehjeve kufizuese të tilla si “trajtim i ndryshëm vetëm...ose ekskluzivisht i bazuar mbi një shkak të tillë si.....” duhet të shmanget.

#### *Paragrafi 5 i Rekomandimit*

14. Në paragrafin e tij të 5-të, Rekomandimi parashikon mundësinë e marrjes së masave të posaçme, të përkohshme të caktuara gjithashtu për të parandaluar ose kompensuar dëmet që pësojnë personat për një nga shkaqet e renditura ose për të lehtësuar pjesëmarrjen e plotë të tyre në çdo fushë të jetës. Një shembull i masave të posaçme, të përkohshme të caktuara për parandalimin ose kompensimin e dëmeve të lidhura me shkaqet e renditura do të ishte: një pronar fabrike, i cili nuk ka punëtorë me ngjyrë në stafin menaxhues, por shumë punëtorë zezakë në asamble, mund të organizojë një kurs trajnimi për punëtorët me ngjyrë që kërkojnë rritje në detyrë. Një shembull i masave të posaçme, të përkohshme të caktuara për lehtësimin e pjesëmarrjes së plotë në të gjitha fushat e jetës për personat e caktuar nga shkaqet e renditura do të ishte: policia mund të organizojë një fushatë rekrutuese të caktuar për të inkurajuar aplikime, veçanërisht nga anëtarët e një grupi etnik të caktuar të cilët nuk kanë përfaqësim të mjaftueshëm brenda policisë.

#### *Paragrafi 6 i Rekomandimit*

15. Rekomandimi specifikisht përmend në paragrafin 6 akte të caktuara të cilat duhen konsideruar nga ligji si forma diskriminimi. Teorikisht, zbatimi i parimeve të përgjithshme ligjore dhe përkufizimi i diskriminimit duhet të mundësojë parashikimin e këtyre akteve në legjislacionin e brendshëm. Megjithatë, praktika tregon se këto akte shpesh tentojnë të mos vihen re ose të përjashtohen nga qëllimi i zbatimit të legjislacionit. Për arsye

efektiviteti, mundet për pasojë të jetë e vlefshme për ligjin të parashikojë shprehimisht që këto akte të konsiderohen si forma diskriminimi.

16. Midis akteve të cilat Rekomandimi i përmend specifikisht si forma diskriminimi, në vazhdim përcaktohet një shpjegim i përmbledhur:
  - Izolimi, është akti me të cilin një person (fizik ose juridik), veçon persona të tjerë mbi bazën e një prej shkaqeve të renditura, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, në përputhje me përkufizimin e sugjeruar të diskriminimit. Për pasojë, vetë akti i vullnetshëm i veçimit nga personat e tjerë mbi bazën e një prej shkaqeve të renditura nuk përbën izolim.
  - Diskriminimi nga përkatësia shoqërore ndodh kur një person diskriminohet negativisht mbi bazën e rrethit shoqëror të tij/saj ose kontaktimit me një ose disa nga personat e caktuar në shkaqet e renditura. Ky do të ishte rasti, për shembull, i refuzimit për të punësuar një person sepse ajo ose ai është e/i martuar me një person që i përket një grupi të caktuar etnik.
  - Qëllimi i shfaqur për të diskriminuar duhet të konsiderohet si diskriminim edhe në mungesë të një viktime konkrete. Për shembull, një lajmërim punësimi që tregon se Romët/Egjiptianët nuk kanë nevojë të aplikojnë, duhet të ndodhet në kufijtë e sferës së legjislacionit, edhe nëse Romët /Egjiptianët faktikisht kanë aplikuar.

#### *Paragrafi 7 i Rekomandimit*

17. Në përputhje me paragrafin 7 të Rekomandimit, ndalimi i diskriminimit duhet të zbatohet në të gjitha fushat. Përsa i përket punësimit, ndalimi i diskriminimit duhet të përfshijë aksesin në punësim, profesion dhe vetëpunësim si edhe kushtet e punësimit, pagesat, ngritjen në detyrë dhe shkarkimin nga puna.
18. Përsa i përket sindikatave, ndalimi i diskriminimit duhet të mbulojë: anëtarësimin në një organizatë punëdhënësish ose punëmarrësish, ose në çdo organizatë anëtarët e së cilës kanë një profesion të veçantë; pjesëmarrjen në organizata të tilla dhe përfitimet e parashikuara për organizata të tilla.
19. Përsa i përket arsimit, ndalimi i diskriminimit duhet të përfshijë arsimin parashkollor, fillor, të mesëm dhe të lartë, si privat ashtu edhe atë publik. Gjithashtu, aksesin në arsim nuk duhet të varet nga statusi i migrimit të fëmijëve apo të të afërmeve të tyre.
20. Përsa i përket trajnimeve, ndalimi i diskriminimit duhet të përfshijë trajnimin profesional fillestar dhe në vazhdim, të gjitha tipet dhe nivelet e drejtimit profesional, trajnimin profesional të përparuar dhe ritrajnimin, duke përfshirë dhe përvetësimin e eksperiencës praktike në punë.
21. Përsa i përket strehimit, diskriminimi duhet të përqëndrohet veçanërisht në aksesin për strehim, në kushtet për tu strehuar dhe në përfundimin e kontratave të qerasë.
22. Përsa i përket shëndetësisë, diskriminimi duhet të përqëndrohet veçanërisht në aksesin për kujdes dhe trajtim dhe në mënyrën sesi ai jepet dhe sesi trajtohen pacientët.

23. Përsa i përket mbrojtjes sociale, ndalimi i diskriminimit duhet të përfshijë sigurimet shoqërore, përfitimet sociale, ndihmën sociale (përfitimet në strehim, përfitimet për të rinjtë, etj) dhe mënyrën sesi trajtohet mbrojtja sociale.
24. Përsa i përket të mirave dhe shërbimeve të caktuara për shoqërinë dhe vendet publike, diskriminimi duhet të përqëndrohet, për shembull në rastet kur blejmë mallra në dyqan, kur aplikojmë për një hua në bankë dhe për hyrjen në diskoteka, kafe ose restorante. Ndalimi i diskriminimit nuk duhet të ketë si objektiv vetëm ata që prodhojnë të mirat dhe shërbimet e disponueshme për të tjerët, por edhe ata që i përfitojnë këto të mira dhe shërbime nga të tjerët, siç do të ishte rasti i një kompanie e cila zgjedh furnizimet me një të mirë ose shërbim të dhënë mbi bazën e një prej shkaqeve të renditura.
25. Përsa i përket ushtrimit të aktivitetit ekonomik, kjo fushë duhet të përfshijë ligjin e konkurrencës, marrëdhëniet midis ndërmarrjeve dhe marrëdhëniet midis ndërmarrjeve dhe shtetit.
26. Fusha e shërbimeve publike përfshin veprimtarinë politike dhe ligjet e tjera detyruese, organet drejtuese zyrtare, ushtrinë dhe personelin e burgjeve.

#### *Paragrafi 8 i Rekomandimit*

27. Në përputhje me paragrafin 8 të Rekomandimit, ligji duhet të vendosë autoritetet publike nën detyrimin për të përkrahur barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre. Detyrimi që bie mbi këto autoritete duhet të shkruhet fjalë për fjalë në mënyrë sa më të qartë në ligj. Nga ky përfundim, autoritetet publike duhet të vendosen nën detyrimin për të krijuar dhe plotësuar "programe barazie" të ngritura me ndihmën organit të barazisë referuar paragrafit 24 të Rekomandimit. Ligji duhet të parashikojë për caktimin në mënyrë të vazhdueshme të këtyre programeve, monitorimin e efekteve të tyre si edhe për zbatimin efektiv të këtij mekanizmi edhe mundësinë për detyrueshmërinë ligjore të këtyre programeve, sidomos përmes organeve kombëtare të specializuara. Një program barazie mundet për shembull të përfshijë caktimin e një personi kontakti për tu marrë me çështjet e diskriminimit racial dhe shqetësimet ose organizimet e stafit të kursit trainues mbi diskriminimin. Përsa i përket detyrimit për të përkrahur barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin, Rekomandimi përfshin vetëm autoritetet publike, megjithatë do të ishte e dëshirueshme që sektori privat të vihej gjithashtu nën një detyrim të ngjashëm.

#### *Paragrafi 10 i Rekomandimit*

28. Në përputhje me paragrafin 10 të Rekomandimit, për raste emergjente, procedurat e përshpejtuara, lidhur me vendimet e përkohshme, duhet të jenë të disponueshme për viktimat e diskriminimit. Këto procedura janë të rëndësishme kur pasojat e menjëhershme të akteve diskriminuese të pretenduara janë sidomos serioze ose madje të pariparueshme. Kështu për shembull, viktimat e një dëbimi diskriminues nga një apartament duhet të jenë të afta ta pezullojnë këtë masë nëpërmjet një vendimi gjyqësor të përkohshëm, në pritje të vendimit përfundimtar të çështjes.

### *Paragrafi 11 i Rekomandimit*

29. Duke patur parasysh vështirësitë që ndesh paditësi për të mbledhur provat e nevojshme në çështjet e diskriminimit, ligji duhet të lehtësojë provat e diskriminimit. Për këtë arsye, në përputhje me paragrafin 11 të Rekomandimit, ligji duhet të parashikojë për ndarje të barrës së provës për këto raste. Ndarje e barrës së provës do të thotë që paditësi duhet të vërtetojë faktet që i lejojnë të prezumojë për diskriminimin. Më pas përgjegjësia do të zhvendoset tek i padituri për të provuar që nuk ka vend për diskriminim. Kështu, në rastin e prezumimit të një diskriminimi racial të drejtëpërdrejtë, i padituri duhet të provojë që trajtimi i ndryshëm ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Për shembull, nëse hyrja në një pishinë u refuzohet fëmijëve Romë/Egjiptianë, do të ishte e mjaftueshme për të paditurin të provonte se hyrja u është mohuar këtyre fëmijëve dhe u është lejuar fëmijëve jo Romë/Egjiptianë. I padituri do të duhet të provojë se ky mohim për të pasur të drejtë hyrjeje është i bazuar në një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, si fakti që fëmijët në fjalë nuk kanë kapuç uji për t'u larë siç kërkohet për të hyrë në pishinë. I njëjti parim duhet të zbatohet për prezumimin e një diskriminimi racial indirekt.
30. Përsa i përket mundësisë për të siguruar provat e nevojshme dhe informacionin, gjykata duhet të ketë të gjitha kompetencat për ta bërë këtë. Këto kompetenca mundet gjithashtu t'i jepen çdo organi barazie të specializuar në gjykimin mbi një ankesë individuale diskriminimi.(shih paragrafin 21 të Rekomandimit Nr. 2 të Politikave të Përgjithshme).

### *Paragrafi 12 i Rekomandimit*

31. Paragrafi 12 i Rekomandimit konstaton se ligji duhet të parashikojë sanksione efektive, proporcionale dhe bindëse për rastet e diskriminimit. Përveç pagimit të kompensimit të dëmit moral dhe material, sanksionet duhet të përfshijnë masa të tilla si kthimin e të drejtave të cilat i kishin humbur. Për shembull, ligji duhet t'i mundësojë gjykatës të urdhërojë ripranimin në një firmë ose apartament, nëse janë respektuar të drejtat e palëve të treta. Në rastin e një refuzimi diskriminues për të punësuar një person, ligji duhet të parashikojë që, sipas rrethanave, gjykata të urdhërojë punëdhënësin t'i ofrojë punësim personit të diskriminuar.
32. Në rastin e diskriminimit nga një shkollë private, ligji duhet të parashikojë mundësinë për t'i hequr akreditimin e fituar nga shkolla ose mosnjohjen e diplomave të lëshuara. Në rastin e një diskriminimi nga një institucion i hapur për publikun, ligji duhet të parashikojë mundësinë e heqjes së licensës dhe të mbylljes së institucionit. Për shembull, në rastin e diskriminimit nga një diskotekë, duhet të parashikohet mundësia për heqjen e licensës për pijet alkoolike.
33. Mënyrat e ndreqjes jo monetare, të tilla si publikimi i të gjithë ose i një pjese të vendimit gjyqësor, mund të jenë të rëndësishme në pasqyrimin e drejtësisë për çështjet e diskriminimit.
34. Ligji duhet të parashikojë mundësinë e vendosjes së një programi masash pozitive për diskriminuesin. Ky është një model i rëndësishëm shërimi për të mbështetur ndryshimet afatgjata në një organizatë. Për shembull, diskriminuesi mund të detyrohet të organizojë për stafin e tij, programe specifike trajnimi që kanë për qëllim luftën kundër racizmit dhe

diskriminimit racial. Organi i barazise duhet të marre pjesë në zhvillimin dhe vrojtimin e këtyre programeve.

#### *Paragrafi 15 i Rekomandimit*

35. Në përputhje me paragrafin 15 të Rekomandimit ligji duhet të parashikojë se ngacmimi i lidhur me një nga shkaqet e renditura është i ndaluar. Ngacmimi konsiston në sjellje të lidhura me një nga shkaqet e renditura, të cilat kanë për qëllim ose sjellin si pasojë dhunimin e dinjitetit të një personi dhe krijimin e një mjedisi kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues. Aq sa është e mundur, mbrojtja kundër ngacmimeve të lidhura me një nga shkaqet e renditura, nuk duhet të ketë si synim vetëm sjelljen e autorit të ngacmimit, por gjithashtu edhe sjelljen e personave të tjerë. Për shembull, punëdhënësi mund të mbajë përgjegjësi kur është i zbatueshem, për ngacmimin nga kolegët, punëmarrësit e tjerë ose palët e treta (si klientët ose furnizuesit).

#### *Paragrafi 16 i Rekomandimit*

36. Paragrafi 16 konstaton se ligji duhet të parashikojë detyrimin për t'i dhënë fund financimit publik të partive politike të cilat përkrahin racizmin. Për shembull, financimi publik për fushatë elektorale duhet të refuzohet për të tilla parti politike.

#### *Paragrafi 17 i Rekomandimit*

37. Paragrafi 17 i Rekomandimit thekson se ligji duhet të parashikojë mundësinë e shpërbërjes së organizatave të cilat përkrahin racizmin. Në të gjitha rastet, shpërbërja e organizatave të tilla mund të bëhet vetëm me vendim gjyqësor. Çështja e shpërbërjes së këtyre organizatave është trajtuar gjithashtu në Seksionin IV-Ligji Penal (shih paragrafët 43 dhe 49 të Memorandumit shpjegues).

### **IV. Ligji penal**

#### *Paragrafi 18 i Rekomandimit*

38. Rekomandimi kufizon sferën e shkeljeve të caktuara të dhëna në paragrafin 18 me kushtin që ato të kryhen në publik. Praktika aktuale tregon se për raste të caktuara, sjelljet raciste nuk i nënshtrohen ndjekjes penale sepse nuk konsiderohen si të një natyre publike. Për pasojë shtetet anëtare duhet të sigurojnë që nuk do të jetë shumë e vështirë për të plotësuar kushtet që të konsiderohet si e bërë në publik. Kështu për shembull, kushti duhet të ndeshet në rastet e fjalëve të shprehura gjatë një mbledhjeje të një organizate neo-naziste ose për fjalë të shkëmbyera në një diskutim në forumet në internet.
39. Disa nga shkeljet e dhëna në paragrafin 18 të Rekomandimit kanë të bëjnë me sjelljen ndaj “një grupimi personash”. Praktika aktuale tregon se masat ligjore me qëllim sanksionimin e sjelljeve raciste, shpesh nuk e përfshijnë një sjellje të tillë nëse nuk është e drejtuar kundër një personi të veçantë ose një grup personash. Për pasojë, shprehje të drejtuara një grupi të madh personash, si në rastin referuar azilkërkuesve ose të huajve në përgjithësi, janë shpesh të papërfshira në keto masa. Për këtë arsye, paragrafi 18 a, b, c dhe d i këtij Rekomandimi nuk flet për një “grup”, por për një “grupim” personash.



40. Termi "shpifje" i përcaktuar në paragrafin 18/b duhet të kuptohet në një sens të gjerë, duke përfshirë sidomos *shpif* dhe *shpif kundër*.
41. Paragrafi 18/e i Rekomandimit i referohet krimit të Genocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës. Krimi i genocidit duhet të kuptohet sipas përkufizimit të dhënë në Artikullin II të Konventës mbi Parandalimin dhe Ndëshkrimin e Krimit të Genocidit dhe Artikullit 6 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve (shih paragrafin 45 të Memorandumit shpjegues). Krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës duhet të kuptohen si në përkufizimet e dhëna në Artikullin 7 dhe 8 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve.
42. Paragrafi 18/f i Rekomandimit i referohet propagandës, shpërndarjes, prodhimit ose ruajtjes së shkrimeve, pikturave ose materialeve të tjera me përmbajtje që shprehin racizëm. Këto nocione përfshijnë dhe shpërndarjen e këtyre materialeve përmes internetit. Materiale të tilla përfshijnë regjistrime, kaseta dhe kompakt disqe, aksesore kompjuterash (disketa, programe etj), video regjistrimi, DVD dhe lojra.
43. Paragrafi 18/g i Rekomandimit parashikon penalizimin e disa veprimeve të caktuara të lidhura me grupe të cilët përkrahin racizmin. Koncepti i grupit përfshin sidomos grupet *de facto*, organizatat, shoqatat dhe partitë politike. Rekomandimi parashikon se krijimi i një grupi i cili përkrah racizmin duhet të ndalohet. Ky ndalim përfshin gjithashtu financimin ose rikrijimin e një grupi i cili ka qenë i ndaluar. Çështja e shpërbërjes së një grupi që përkrah racizmin është shqyrtuar gjithashtu në Seksionin III-Ligji civil dhe administrativ (shih paragrafin 37 të Memorandumit shpjegues) dhe më poshtë (shih paragrafin 49 të Memorandumit shpjegues). Për më tepër, nocioni "mbështetje" përfshin veprime të tilla si sigurim financimi të grupit, sigurim të çdo materiali tjetër të nevojshëm prodhimin ose sigurimin e dokumentave.
44. Në paragrafin 18/h, Rekomandimi konsiston në atë që ligji duhet të penalizojë diskriminimin racial në ushtrimin e një detyre ose profesioni publik. Mbi këtë çështje përkufizimi i dhënë në paragrafet 1/b dhe c dhe 5 të Rekomandimit zbatohen *mutatis mutandis*. Diskriminimi racial në ushtrimin e një detyre ose profesioni publik përfshin veçanërisht refuzimin diskriminues për kujdes spitalor ndaj një personi dhe refuzimin diskriminues për të shitur produkte, për të garantuar një hua bankare ose për të lejuar hyrjen në një diskotekë, kafe ose restorant.

#### *Paragrafi 19 i Rekomandimit*

45. Paragrafi 19 i Rekomandimit parashikon se ligji duhet të penalizojë genocidin. Krimi i genocidit duhet kuptuar sipas përkufizimit të Artikullit II të Konventës Për Parandalimin dhe Ndëshkrimin e Krimit të Genocidit dhe atij të Artikullit 6 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve, sipas të cilëve "çdonjëri prej akteve në vazhdim i kryer me qëllimin për të shkatërruar tërësisht ose pjesërisht një grup nacional, etnik, racial ose fetar, akte të tilla si: vrasja e anëtarëve të grupit; dëmtime të rënda fizike dhe psikike të anëtarëve të grupit; shkatërimi me paramendim i kushteve të rënda të jetesës së grupit të llogaritura për t'i shkatërruar fizikisht, tërësisht ose pjesërisht; zbatimi i masave që synojnë parandalimin e lindjeve brenda grupit; transferimi i detyrueshëm i fëmijëve nga një grup në një tjetër". Rekomandimi i referohet vetëm penalizimit të genocidit dhe jo krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit derisa këto nuk

janë domosdoshmërisht të një natyre raciste. Megjithatë, nëse ato do të paraqiteshin si të tilla, duhet të zbatohen rrethanat rënduese të parashikuara në paragrafin 21 të Rekomandimit.

#### *Paragrafi 20 i Rekomandimit*

46. Paragrafi 20 i Rekomandimit parashikon se nxitja, ndihma, mbështetja ose tentativa për të kryer çdonjërin nga shkeljet e përfshira në paragrafet 18 dhe 19 duhet të ndëshkohet. Ky Rekomandim zbatohet vetëm për ato shkelje për të cilat nxitja, ndihma, mbështetja ose tentativa është e mundur.

#### *Paragrafi 21 i Rekomandimit*

47. Në përputhje me paragrafin 21 të Rekomandimit, motivi racist i autorit të krimit për një shkelje tjetër të ndryshme nga ato të parashikuara në paragrafët 18 dhe 19, duhet të përbëjë rrethanë rënduese. Gjithashtu, ligji mund të penalizojë shkeljet e zakonshme por me motiv racist si shkelje specifike.

#### *Paragrafi 22 i Rekomandimit*

48. Në përputhje me paragrafin 22 të Rekomandimit, ligji duhet të parashikojë përgjegjësinë penale të personave juridikë. Kjo përgjegjësi duhet të veprojë kur shkeljet janë bërë nga një person tjetër por në interes të personit juridik, sidomos kur veprojnë si një organ i personit juridik (psh, Presidenti ose Drejtori), ose si përfaqësuesi i tij. Autoritetet publike mund të përjashtohen nga përgjegjësia penale si persona juridikë.

#### *Paragrafi 23 i Rekomandimit*

49. Në përputhje me paragrafin 23 të Rekomandimit, ligji duhet të parashikojë sanksione alternative ose ndihmëse. Shembuj të këtyre sanksioneve mund të përfshijnë punën në komunitet, pjesëmarrjen në kurse trainimi, privimin nga disa të drejta civile ose politike (si psh. e drejta për të ushtruar profesione ose funksione të caktuara, e drejta për të votuar ose për t'u zgjedhur), ose publikimi i të gjithë ose të një pjese të vendimit gjyqësor. Përsa i përket personave juridike lista e sanksioneve të mundshme duhet të përfshijë, përveç gjobës: refuzimin ose ndalimin e përfitimeve dhe ndihmës publike, përjashtimin nga ushtrimi i aktivitetit tregtar, vendosjen nën mbikqyrjen gjyqësore, mbylljen e institucionit të përdorur për kryerjen e shkeljes, konfiskimin e materialeve të përdorura për kryerjen e shkeljes dhe shpërbërjen e personit juridik (për këtë të fundit shih paragrafin 37 dhe 43 të Memorandumit shpjegues).

## **V. Masa të përgjithshme**

#### *Paragrafi 24 i Rekomandimit*

50. Detajet e krijimit të organeve të barazisë parashikohen në Rekomandimin Nr. 2 të Politikave të Përgjithshme të ECRI-t. .
51. Paragrafët 51 deri në 55 janë fshirë nga RPP nr. 2, i miratuar më 7 dhjetor, 2017.

#### *Paragrafi 25 i Rekomandimit*

52. Rekomandimi parashikon në paragrafin e tij të 25 që organizime të tilla si : shoqata, sindikata dhe entitete të tjera ligjore me një interes legjitim, mund t'u jepet e drejta për të sjellë ankesa. Një masë e tillë është e rëndësishme për shembull në rastet kur viktimat ka frikë nga hakmarrja. Gjithashtu, mundësia që këto organizata të sjellin raste diskriminimi racial pa iu referuar një viktimit konkrete është thelbësore për t'i adresuar ato raste diskriminimi aty ku është e vështirë për të identifikuar një viktimit të tillë ose raste të cilat dëmtojnë një numër të pacaktuar viktimitash.

#### *Paragrafi 27 i Rekomandimit*

53. Në përputhje me paragrafin 27 të Rekomandimit, ligji duhet të parashikojë mbrojtjen kundër hakmarrjes. Një mbrojtje e tillë nuk duhet t'i jepet vetëm personit, i cili nis procesin ose që sjell ankesën, por duhet të shtrihet gjithashtu tek të gjithë ata që sigurojnë prova, informacione ose ndihmë tjetër në lidhje me procesin gjyqësor ose me ankesën. Një mbrojtje e tillë është jetike për të inkurajuar viktimat e krimeve raciste dhe diskriminimit, për të parashtruar ankesat e tyre tek autoritetet dhe për të inkurajuar dëshmitarët për të dhënë prova. Në mënyrë që të jenë efektive, masat ligjore mbrojtëse kundër hakmarrjes duhet të parashikojnë për një sanksion të qartë dhe të përshtatshëm. Kjo mund të përfshijë mundësinë e një urdhërimi të një vendimi gjyqësor për të ndaluar aktet hakmarrëse dhe/ose kompensimin e viktimitave për akte të tilla.



